



Zgjatja e afatit - Kërkesë për Kuotim (KPK)

Tender ID:	420/25
Titulli:	Shërbime transporti të rregullt me autobus për nevoja të TEB SH.A.
Data e shpalljes:	30.10.2025
Data e mbylljes:	12.11.2025

I) OBJEKTIVI:

Qëllimi i këtij tenderi është të ftojë ofruesit e shërbimeve të transportit që t'i dorëzojnë ofertat e tyre për Shërbime transporti të rregullt me autobus për nevojat e TEB SH.A., në pajtim me Fushën e shërbimeve si më poshtë:

II) FUSHËVEPRIMI I SHËRBIMIT:

Ofruesi i Shërbimeve duhet të jenë në gjendje të:

- Ofrojë transport të rregullt për punonjësit e TEB Sh.A, me numër të mjaftueshëm të autobusëve dhe të kapaciteteve për këtë numër të pasagjerëve:
- Transporti i gjithsej numrit të pasagjerëve: **rreth 200 punonjës në mëngjes dhe pasdite, në dy drejtime!**
- Shërbimi i transportit me autobus duhet të organizohet dy herë në ditë, në mëngjes dhe pasdite, parimisht sipas orarit në vijim në dy drejtime nga qyteti dhe anasjelltas:

DESTINACIONI: 1. Qyteti Prishtinë Prapa Teatrit – TEB SH.A. Zyra Qendrore (në mëngjes)

TEB SH.A. Zyra Qendrore - Qyteti Prishtinë Prapa Teatrit (pasdite)

2. Maxi Rruga B - TEB SH.A. Zyra Qendrore (në mëngjes)

TEB SH.A. Zyra Qendrore - Maxi Rruga B (pasdite)

TEB SH.A. Zyra Qendrore gjindet në rrugën kryesore Prishtinë - Shkup (në anën e djathtë), afër 'HIB Petrol Station', në vendin e quajtur Preocë, Komuna e Graçanicës, rreth 7km larg nga qendra e qytetit të Prishtinës.



Transporti në mëngjes

Drejtimi: 1. Prishtinë TEB Prapa Teatrit – TEB SH.A. Zyra Qendrore dhe
2. Maxi Rruga B - TEB SH.A. Zyra Qendrore
Autobusët do të kenë së paku 4 (katër) pranime të udhëtarëve gjatë udhëtimit në drejtim të destinacionit kryesor.

Koha e nisjes: 08:00 nga vendi i ndaljes/pranimit të parë të udhëtarëve.

Frekuenca: Pesë herë në javë (**e hënë - e premte**)

Transporti pasdite

Drejtimi: 1. TEB SH.A. Zyra Qendrore - Qyteti Prishtinë TEB Prapa Teatrit dhe
2. TEB SH.A. Zyra Qendrore - Maxi Rruga B
Autobusët do të kenë së paku 4 (katër) pranime të udhëtarëve gjatë udhëtimit në drejtim të destinacionit kryesor.

Koha e nisjes: 16:40 nga vendi i ndaljes/pranimit të parë të udhëtarëve.

Frekuenca: Pesë herë në javë (**e Hënë - e Premte**).

- Të ofrojë shërbime cilësore e me kohë duke përdorur autobusë me komoditet të lartë e të sigurt, dhe për këtë qëllim, në përputhje me kërkesat e ligjit për funksionimin e trafikut;
- Ofruesi i suksesshëm i Shërbimeve do të kontraktohet për një periudhë 1 vjeçare, me vazhdim të kontratës për periudhën vijuese në baza vjetore, varësisht nga performanca e Ofruesit të Shërbimeve gjatë vitit të parë kontratës.
- Ofruesi i Shërbimeve duhet të jetë në gjendje të plotësojë kërkesat e nevojshme dhe përgatitjet për të filluar ofrimin e shërbimeve, jo më vonë se më 01 Dhjetor 2025.

III) Kërkesat financiare dhe të tjera që duhet të merren parasysh në ofertë:

- Ofruesi i Shërbimeve duhet të ketë autorizimet e duhura për të ofruar shërbime të transportit të rregullt, bashkë me lejet dhe licencat adekuate për këto aktivitete ashtu siç kërkohet me ligjet në Kosovë për transportin e udhëtarëve;

Oferta financiare duhet të ipet në valutën EUR dhe me TVSH, si dhe duke përfshirë tatimet e tjerat të aplikueshme në Kosovë. Në rast se TVSH-ja nuk figuron në çmim, TEB do ta konsideroj atë si të përfshirë në çmim;

- Oferta financiare duhet të jetë e vlefshme deri në **90 ditë!**

**IV) DOKUMENTACIONI SHITESË NË MBËSHTETJE TË OFERTËS:**

- Lejet/licencat për ushtrimin e shërbimit të transportit të rregullt me autobus në territorin e Republikës së Kosovës dhe në pajtim me legjislacionin dhe kërkesat rregullative në Kosovë.
- Referencat me shkrim;
- Personeli dhe kapacitetet (duke përfshirë përvojën e tyre si vozitës)
- Numri i autobusëve dhe mjeteve të transportit që do të përdoret për këtë qëllim;
- Çfarëdo të dhëne tjetër me rëndësi që ka të bëjë me Fushëveprimin e shërbimit dhe kërkesat;

IV) DORËZIMI I OFERTAVE/ Termat dhe kushtet:

- Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, në adresën e mëposhtme:
- **TEB SH.A. "Preoc nr. Graçanicë 10500, km 7 rruga kryesore Prishtinë-Ferizaj, Republika e Kosovës"**
- **Afatin për dorëzim të ofertave:** Më së largu deri më **12.11.2025, ora 15:30**.
- TEB SH.A. mban të drejtën për të bërë çfarëdo ndryshim në termat e referencës, të ftojë prap ofertuesit që t'i ri-dorëzojnë ofertat, ose të anulojnë këtë tender pa dhënë ndonjë arsytim apo njoftim me shkrim!
- Për çdo pyetje, informatë ose shpjegim shtesë lidhur me specifikimin teknik të ofertës, luteni të i drejtoheni me shkrim adresës së mëposhtme elektronike: procurement@teb-kos.com